



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	No.Nr. 130-26
Tarih/Dt.	29.05.2026

ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 130-26

Me datë: 29.05.2026

Komuna e Mamushës

Në bazë të në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 53 paragrafi 1 lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M Për anulimin e vendimeve

Neni 1

ANULOHEN – Vendimet sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ, dhe atë si në vijim:

- Vendimi për ndryshim në listën e pagave, me nr. të protokollit 02.Nr.288/25, të datës 31.12.2025,
- Vendimi për ndryshim në listën e pagave me nr. të protokollit nr. 02.Nr.30/26, të datës 09.02.2026,
- Vendimi për pagesën retroaktive me nr. të protokollit 02.Nr.55/26 të datës 06.03.2026,
- Vendimi për pagesën retroaktive me nr. të protokollit 02.Nr.82/26 të datës 10.04.2026, të nxjerra për znj. Fitore Bytyçi, sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ.
- Ndërsa Vendimi për pagesën retroaktive nr. 02.Nr.100/26 e datës 04.05.2026 mbetet në fuqi dhe se i njëjti ka krijuar efekt juridik.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Vendimet e lartcekura janë nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe janë proceduar në Thesar për ekzekutim lidhur me pagesën e shtesës mbi vëllimin e punës. Mirëpo, për shkak të mosmiratimit në kohë të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, shpenzimet buxhetore gjatë periudhës përkatëse janë realizuar vetëm sipas financimit

të përkohshëm në masën 1/12 të buxhetit. Përkundër miratimit të mëvonshëm të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, vendimet në fjalë nuk janë ekzekutuar nga Thesari dhe, rrjedhimisht, nuk kanë prodhuar efekte juridike dhe financiare.

Duke marrë parasysh se vendimet kanë mbetur të pazbatuara dhe pa efekt juridik në praktikë, si dhe me qëllim të harmonizimit të gjendjes administrative dhe financiare me gjendjen faktike, është vendosur anulimi i tyre sipas detyrës zyrtare nga organi kompetent.

Njoftohen:

- NJMBNJ
- Arkiva





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
No.Nr. 02 729-26		
Tarih/Dt. 29.05.2026		

ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 125 -26

Me datë: 29.05.2026

Komuna e Mamushës

Në bazë të në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 53 paragrafi 1 lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për anulimin e vendimeve

Neni 1

ANULOHEN – Vendimet sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ, dhe atë si në vijim:

- Vendimi për ndryshim në listën e pagave dhe pagesën retroaktive, me nr. të protokollit 02.Nr.48/26, të datës 02.03.2026,
- Vendimi për ndryshim në listën e pagave dhe pagesën retroaktiveme me nr. të protokollit 02.Nr.86/26, të datës 10.04.2026, të nxjerra për z. Alban Sadiki, sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ.
- Ndërsa Vendimi për ndryshim në listën e pagave dhe pagesën retroaktive me nr. të protokollit 02.Nr.101/26 e datës 04.05.2026 mbetet në fuqi dhe se i njëjti ka krijuar efekt juridik.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Vendimet e lartcekura janë nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe janë proceduar në Thesar për ekzekutim lidhur me pagesën e shtesës mbi vëllimin e punës. Mirëpo, për shkak të mosmiratimit në kohë të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, shpenzimet buxhetore gjatë periudhës përkatëse janë realizuar vetëm sipas financimit të përkohshëm në masën 1/12 të buxhetit. Përkundër miratimit të mëvonshëm të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, vendimet në fjalë nuk janë ekzekutuar nga Thesari dhe, rrjedhimisht, nuk kanë prodhuar efekte juridike dhe financiare.

Duke marrë parasysh se vendimet kanë mbetur të pazbatuara dhe pa efekt juridik në praktikë, si dhe me qëllim të harmonizimit të gjendjes administrative dhe financiare me gjendjen faktike, është vendosur anulimi i tyre sipas detyrës zyrtare nga organi kompetent.

Njoftohen:

- NJMBNJ
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 128-26

Me datë: 29.05.2026

Komuna e Mamushës

Në bazë të në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 53 paragrafi 1 lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për anulimin dhe shfuqizim të vendimeve

Neni 1

ANULOHEN – Vendimet sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ, dhe atë si në vijim:

- Vendimi për caktimin e Ushtresit të Detyrës në pozitën e U.D. Udhëheqësit të Prokurimit Publik në Komunën e Mamushës, me nr. të protokollit 02.Nr.46/26, të datës 02.03.2026, shfuqiztohet nga data 29.05.2026.
- Vendimi për ndryshim në listën e pagave me nr. të protokollit 02.Nr.54/26, të datës 05.03.2026,
- Vendimi për pagesë retroaktive me nr. të me nr. të protokollit nr. 02.Nr.98/26, të datës 04.05.2026, si dhe
- Vendimi për pagesë retroaktive me nr. të protokollit 02.Nr.99/26, të datës 04.05.2026, të nxjerra për z. Mehmet Morina, sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Vendimet e lartcekura janë nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe janë proceduar në Thesar për ekzekutim lidhur me pagesën e shtesës mbi vëllimin e punës. Mirëpo, për shkak të mosmiratimit në kohë të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, shpenzimet buxhetore gjatë periudhës përkatëse janë realizuar vetëm sipas financimit të përkohshëm në masën 1/12 të buxhetit. Përkundër miratimit të mëvonshëm të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, vendimet në fjalë nuk janë ekzekutuar nga Thesari dhe, rrjedhimisht, nuk kanë prodhuar efekte juridike dhe financiare.

Duke marrë parasysh se vendimet kanë mbetur të pazbatuara dhe pa efekt juridik në praktikë, si dhe me qëllim të harmonizimit të gjendjes administrative dhe financiare me gjendjen faktike, është vendosur anulimi i tyre sipas detyrës zyrtare nga organi kompetent.

Njoftohen:

- NJMBNJ
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës



Abdülhadi Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing		
02	No.Nr. 127-26	
Tarih/Dt.	29.05.2026	

ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 127 -26

Me datë: 29.05.2026

Komuna e Mamushës

Në bazë të në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 53 paragrafi 1 lidhur me nenin 58 të Ligjit nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M Për anulimin e vendimeve

Neni 1

Aprovohet- kërkesa e znj. Xhevahire Gashi – Zyrtare Kryesore Financiare në Komunën e Mamushës me nr. të protokollit 02.Nr.25/26 e datës 25.05.2026. ashtu që:

ANULOHEN – vendimet sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ, si dhe bazuar në kërkesën me nr. të protokollit 02.Nr.25/26 e datës 25.05.2026 dhe atë si në vijim

- Marrëveshjes për Shtesën e Vëllimit të punës me nr. të protokollit 02.Nr.224/25/26, të datës 31.12.2026,
- Vendimi mbi shtesën e vëllimit të punës me nr. të protokollit 02.Nr.289/26, të datës 31.12.2026,
- Vendimi mbi shtesën e vëllimit të punës me nr. të protokollit 02.Nr.56/26, të datës 06.03.2026,
- Vendimi për pagesën në mëyrë retroaktive sipas marrëveshjes për Shtesën e Vëllimit të Punës me nr. të protokollit 02.Nr.79/26, të datës 10.04.2026, si dhe
- Vendimi për pagesën në mëyrë retroaktive sipas marrëveshjes për Shtesën e Vëllimit të Punës me nr. të protokollit 02.Nr.97/26, të datës 04.05.2026, të nxjerra për znj. Xhevahire Gashi, sipas detyrës zyrtare nga organi publik kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Vendimet e lartcekura janë nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe janë proceduar në Thesar për ekzekutim lidhur me pagesën e shtesës mbi vëllimin e punës. Mirëpo, për shkak të mosmiratimit në kohë të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, shpenzimet buxhetore gjatë periudhës përkatëse janë realizuar vetëm sipas financimit të përkohshëm në masën 1/12 të buxhetit. Përkundër miratimit të mëvonshëm të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, vendimet në fjalë nuk janë ekzekutuar nga Thesari dhe, rrjedhimisht, nuk kanë prodhuar efekte juridike dhe financiare.

Duke marrë parasysh se vendimet kanë mbetur të pazbatuara dhe pa efekt juridik në praktikë, si dhe me qëllim të harmonizimit të gjendjes administrative dhe financiare me gjendjen faktike, është vendosur anulimi i tyre sipas detyrës zyrtare nga organi kompetent.

Njoftohen:

- NJMBNJ
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



02 Nr. 126 / 26
Më: 29.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: “FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES MEDICINAL PËR LABORATOR DHE MATERIAL DENTAR PËR QKMF-n NË KOMUNËN E MAMUSHËS” me numër të prokurimit: 626-26-624-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm 626-26-002-1-2-1, emërohet z. Mirat Morina, ndërsa Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Emre Şala.

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin “Fillimi/mobilizimi i kontratës”. Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;

- b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
- c. Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- *Drejtoria e Shëndetesisë dhe mirëqenies sociale,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

Abdülhadi Krasniç
Kryetari i Komunës së Mamushës





REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



02 Nr. 125 / 26
Më: 29.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: "Rregullimi i infrastrukturës përcjellëse të rrugëve fushore bujqësore Leska-Nisra-Lika-Asker"-Punë shtesë" me numër të prokurimit: 626-26-2515-5-2-5 dhe me nr. të brendshëm 626-26-004-5-2-5, emërohet z. Erdinç Morina, ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Rujdi Mazrek.

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi/mobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;

- b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
- c. Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimindhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- *Drejtoria e Bujqesisë,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

Abdülhadi Krasniç
Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

02- Nr. 129-26

Me datë 28.05.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 67 paragrafi 1 pika 1.3 neni 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, në lidhje nenin 87 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kontratën në kohë të caktuar të punës me numër të protokollit 02.Nr.01/26 e datës 08.01.2026 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me kontratë me kohë të caktuar.

Neni I

znj. Drenusha Shukaj, e sistemuar në pozitën e Mësimdhënëses së Gjuhës Angleze për paralelet shqipe në SH.F.M.U. “ANADOLU”, sipas Kontratës së Punës me kohë të caktuar me nr. protokollit 02.Nr.01/26 të datës 08.01.2026, i përfundon marrëdhënia e punës në Shërbimin Publik me datën 22.06.2026, për shkak të kthimit nga pushimi i lehonisë të mësimdhënëses të cilën e ka zëvendësuar.

Neni II

Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që, nga data 22.06.2026, ta largojë të lartpërmendurën nga lista e pagave dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij, ndërsa efektet juridike i prodhon nga data 22.06.2026.

A R S Y E T I M

znj. Drenusha Shukaj ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar me Komunën e Mamushës, për zëvendësimin e mësimdhënëses znj. Albana Iggji, e cila ka qenë në pushim të lehonisë, në pozitën Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze për paralelet shqipe në SH.F.M.U. “ANADOLU”.

Mësimdhënësjja e zëvendësuar ka njoftuar punëdhënësin se me datën 23.06.2026 do të rikthehet në vendin e saj të punës, pas përfundimit të periudhës së parë të pushimit të lehonisë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh.

Bazuar në Kontratën e Punës me kohë të caktuar me nr. të protokollit 02.Nr.01/26 e datës 08.01.2026, të lidhur ndërmjet znj. Drenusha Shukaj, si punëmarrëse, dhe Komunës së Mamushës,



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 123-26

Me datë 28.05.2026

Në bazë nenit 13 dhe 58 paragrafi 1 pika (b) të Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, lidhur me nenin 21 të Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrtarët Publik, Nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenit 13 të Rregullore (QRK) nr. 04/2024 Për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për ndërpreje të Pushimt të Lehonisë

Neni 1

Aprovohet kërkesa me numër protokollit 05.Nr.23/26, e datës 28.05.2026, e znj. Albana Iggji, e punësuar në pozitën Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze në Sh.F.M.U. “Anadolu” në Komunën e Mamushës, për ndërprerjen e pushimit të lehonisë pas përfundimit të fazës së parë të tij.

Neni 2

Përmes kërkesës me numër protokollit 05.Nr.23/26, të datës 28.05.2026, znj. Albana Iggji ka njoftuar se nuk dëshiron ta vazhdojë shfrytëzimin e të drejtës për pushim të lehonisë, në pajtim me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.

Neni 3

Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurën ta përcjellë dokumentacionin në Thesarin e Kosovës – Ministrinë e Financave (MF), me qëllim të përfshirjes së saj në listën e pagave me pagë të plotë nga data 23.06.2026, datë në të cilën e njëjta rikthehet në marrëdhënie pune.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij, ndërsa efektet juridike i prodhon nga data 23.06.2026 dhe dorëzohet për zbatim në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA).

Me këtë vendim njoftohet:

- znj. Albana Iggji;
- DKA
- Sh.F.M.U. “Anadolu”
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasnic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 122/26

Me 22.05.2026

Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën e Kontrollit Teknik

Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik Butrinti N.P.SH sipas fletëpagesës nr. 0774/26, e datës 11.03.2026 dhe fletëpagesës 1583/26 e datës 20.05.2026 për shërbimin e kontrollit teknik të automjetit të tipit Peugeot Y(BOXER) me targa 04Z-16-32, me numër të shasisë VF3YDBNFC12R28574.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria “Mallra dhe Shërbime”, sipas përshkrimit, “Kontrolli Teknik” i Automjetit Peugeot Y(BOXER) me targa 04Z-16-32, me numër të shasisë VF3YDBNFC12R28574” të dy faturat e cekura në nenin 1 në shumën 30.00 €, sipas bllokut kodues: 10/626/73850/13954/00000/0721 dhe sipas zotimeve 79968-2026, dhe 79967-2026 për përfituesin: Butrinti N.P.SH N.P.SH Numri unik i biznesit: 811035030, Llogaria bankare 1301001002322766.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet t’i nënshtrohen rregullisht kontrollit teknik, në përputhje me dispozitat ligjore për sigurinë në komunikacion dhe funksionalitetin teknik të mjeteve motorike. Automjeti i tipit Peugeot Y(BOXER) me targa 04Z-16-32, me numër të shasisë VF3YDBNFC12R28574, është pjesë e automjeteve zyrtare Komunës së Mamushës që është në shërbim të QKMF-ës në Komunën e Mamushës. Kryerja e kontrollit teknik është obligim ligjor dhe parakusht për regjistrimin dhe qarkullimin e ligjshëm të automjetit, andaj realizimi i pagesës për këtë shërbim është i domosdoshëm dhe urgjent.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
2. Palëve;
3. Arkiva



Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 121 -26

Me datë: 20.05-2026

Komuna e Mamushës

Në bazë zë nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 60 të Ligji nr. 08/1-197 Për Zyrtarët Publik, nenin 85 të Ligjit nr. 03/1-212 i Punës, neni 82 të Statutit të Komunës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës nxjerr këtë

V E N D I M

Për Formimin e Komisionit Disiplinor në Kuadër të Shërbimit Publik në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare

I

Formohet Komisioni Disiplinor për të zhvilluar procedurën administrative disiplinore për rastet e shkeljeve të shkelje të lehta dhe shkelje të rënda të detyrave të punës, detyrimet të tjera ligjore dhe kodit të mirësjelljes, në Kuadër të Shërbimit Publik në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.

II

Komisioni do të ketë këtë përbërje.

- Emra Morina- Kryesues
- Mehmet Morina Jurist anëtar
- Fitore Bytyçi- U.d NJMBNJ Anëtare

III

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit disiplinore janë të parapara në Ligjin nr. 08/1-197 Për Zyrtarët Publik, lidhur me nenin 85 të Ligjit nr. 03/1-212 i Punës, Mandati i anëtarëve të Komisionit është 2 vjeçar.

Me këtë njoftohen

- Të emëruarit
- Drejtoritë Komunale
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 120 -26

Me datë: 20.05.2026

Komuna e Mamushës

Në bazë zë nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 60 të Ligji nr. 08/l-197 Për Zyrarët Publik, neni 10 Rregullore (QRK) nr. 01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, neni 82 të Statutit të Komunës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës nxjerr këtë

V E N D I M

Për Formimin e Komisionit Disiplinor në Kuadër të Shërbimit Civil në Administratën Komunale

I

Formohet Komisioni Disiplinor për të zhvilluar procedurën administrative disiplinore për rastet e shkeljeve të shkeljeve të lehta dhe shkeljeve të rënda të detyrave të punës, detyrimet të tjera ligjore dhe kodit të mirësjelljes, në kuadër të Shërbimit Civil në Administratën Komunale

II

Komisioni do të ketë këtë përbërje.

- Fitore Bytyçi U.D NJMBNJ Kryesuese
- Suna Morina Juriste anëtare
- Nazmi Morina- Anëtar

III

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit disiplinore janë të parapara në Ligjin nr. 08/l-197 Për Zyrarët Publik, dhe Rregullore (QRK) nr. 01/2024 Për Disiplinën e Nëpunësve Civil, si dhe aktet e brendshme të parapara në nenin 85 të Ligjit nr. 03/l-212 i Punës, Mandati i anëtarëve të Komisionit është 2 vjeçar.

Me këtë njoftohen

- Të emëruarit
- Drejtoritë Komunale
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT

02. Nr. 119-26

Me datë: 20.05.2026

Komuna e Mamushës

Në bazë zë nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 60 të Ligji nr. 08/1-197 Për Zyrtarët Publik, nenin 85 të Ligjit nr. 03/1-212 i Punës, neni 82 të Statutit të Komunës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës nxjerr këtë

V E N D I M

Për Formimin e Komisionit Disiplinor në Kuadër të Shërbimit Publik në Shkollën Filllore dhe te Mesme në Komunën e Mamushës

I

Formohet Komisioni Disiplinor për të zhvilluar procedurën administrative disiplinore për rastet e shkeljeve të shkelje të lehta dhe shkelje të rënda të detyrave të punës, detyrimet të tjera ligjore dhe kodit të mirësjelljes, në Kuadër të Shërbimit Publik në Shkollën Filllore dhe te Mesme në Komunën e Mamushës

II

Komisioni do të ketë këtë përbërje.

- Erol Morina- Kryesues
- Mehmet Morina Jurist anëtar
- Fitore Bytyçi- U.d NJMBNJ Anëtare

III

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit disiplinore janë të parapara në Ligjin nr. 08/1-197 Për Zyrtarët Publik, lidhur me nenin 85 të Ligjit nr. 03/1-212 i Punës, Mandati i anëtarëve të Komisionit është 2 vjeçar.

Me këtë njoftohen

- Të emëruarit
- Drejtoritë Komunale
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 118/26
Me 20.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë për ndërtesat në kuadër të Komunës së Mamushës për vitin 2026-TM2

Neni 1

Konform Marrëveshjeve për Shërbime të Energjisë në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencën e Energjisë(FKEE) dhe Komunës së Mamushës datë 16.03.2022 dhe Aneks Marrëveshjeve datë 19.04.2023 dhe sipas njoftimit datë 05.05.2026 nga FKEE për planin e pagasave të vitit 2026, për ndërtesën e SHFMU Anadolu-Mamushë, Gjimnazin Ataturk-Mamushë, Ndërtesën e Kuvendit Komunal në Mamushë dhe Ndërtesën Shërbimet Komunale në Mamushë.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas shumës 2,492.67.00€ me nr. zotimi 2026-75934 dhënavë në vijim:

Nr.	Përfituesi	ID	Xhirollogaria	Shuma €
1.	FKEE	602200066	1708020600000153	2,492.67.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit dhe për zbatimin e vendimit është përgjegjëse Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtora e Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Fondi i Kosovës për Eficiencën e Energjisë-(FKEE)
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 117/26
Me 20.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë për ndërtesat në kuadër të Komunës së Mamushës për vitin 2026-TM1

Neni 1

Konform Marrëveshjeve për Shërbime të Energjisë në mes të Fondit të Kosovës për Eficiencën e Energjisë(FKEE) dhe Komunës së Mamushës datë 16.03.2022 dhe Aneks Marrëveshjeve datë 19.04.2023 dhe sipas njoftimit datë 27.03.2026 nga FKEE për planin e pagasave të vitit 2026, për ndërtesën e SHFMU Anadolu-Mamushë, Gjymnazin Ataturk-Mamushë, Ndërtesën e Kuvendit Komunal në Mamushë dhe Ndërtesën Shërbimet Komunale në Mamushë.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas shumës 2,492.67.00€ me nr. zotimi 2026-75935 dhënave në vijim:

Nr.	Përfituesi	ID	Xhirollogaria	Shuma €
1.	FKEE	602200066	1708020600000153	2,492.67.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit dhe për zbatimin e vendimit është përgjegjëse Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtora e Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Fondi i Kosovës për Eficiencën e Energjisë-(FKEE)
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushë

Abdülhadi Krasnic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 116 /26
Me 20.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Marrëveshjes ndërmjet Postës së Kosovës SH.A dhe Policisë së Kosovës dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa për shërbime postare-Dërgesa e Gjobave Mars 2026

Neni 1

Aprovohet kërkesa e pagesës e shërbimeve postare për dërgesën në emër të pranimit, bartjes dhe dërgesave në bazë të marrëveshjes për Gjobat e Trafikut për periudhën 01.03.2026 deri më 31.03.2026 sipas Nr. të faturës 03-1/2026- datë 10.04.2026.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit 10/626/17514/1330/00000/0112 shuma 8.50€ me numër zotimi 2026-75950.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Buxhet, Financa
- Posta e Kosovës SH.A
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 115/26
Me 20.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Pagesa e Antarësisë viti 2026 për AZHR-Jug

Neni 1

Aprovohet kërkesa e AZHR-Jug për pagesën vjetore të antarësisë për vitin 2026 sipas kërkesës 02 Nr.22-26 datë 18.05.2026.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Nr.	Blloku Kodues	ID Furnitorit	Xhirollogaria	Shuma €
1.	10/626/48014/13480/00000/0411	51121783	1705001600068752	2,000.00

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Buxhet, Financa
- AZHR-Jug
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 114/26
Me 20.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Pagesa e Antarësisë për Asociacionin e Komunave të Kosovës Viti 2026

Neni 1

Aprovohet kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës për pagesën vjetore të Antarësisë sipas faturës Nr.19/26 datë 02.03.2026.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Nr.	Blloku Kodues	ID Furnitorit	Xhirollogaria	Shuma €
1.	10/626/17514/13480/00000/0112	51018001	1901586841031197	841.05

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Buxhet, Financa
- Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo			
Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa			
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing			
02	No.Nr.	113-26	
Tarih/Dt.		20.05.2026	

02 Nr. 113 /26
Me 20.05.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG me numër të protokollit 02/Nr.69/25 e datës 20.10.2025, Raportin e AZHR JUG me nr. të protokollit 04.Nr.1640/26 e datës 19.05.2026 nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal AZHR Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal AZHR JUG kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-69-25 i datës 20.10.2025 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financo projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 5,271.43 € sipas Raportit të AZHR JUG e datës me numër të protokollit 04.Nr.1640/26 e datës 19.05.2026, pagesën e shumës për periudhën e muajit Maj 2026. Sipas bllokut kodues 10/626/48014/13460/00000/0411 dhe sipas numrit të zotimit 75946-2026 e datës 18.05.2026, me të dhëna si në shkresat e lëndës.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Për Zhvillim Ekonomik;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Palëve;
4. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasnic





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 112-26
Tarih: 18-05-2026

Yerel Yönetimler Kanunu'nun 13 ve 58/b maddeleri, Kosova Cumhuriyeti Resmî Gazetesi No. 28/2008'de yayımlanan 03/L-040 sayılı Yerel Özyönetim Yasası, 08/L-197 sayılı Kamu Görevlileri Yasası'nın 86. maddesinin 2. fıkrası ile bağlantılı olarak 69. maddesinin 1. fıkrası 1.2 alt paragrafı ve 71. maddesi, ayrıca 08/L-294 sayılı Kanun ile değiştirilen ve tamamlanan 08/L-197 sayılı Kamu Görevlileri Yasası'nın 13. maddesinin 3. fıkrası uyarınca, kamu görevlisi Raif Mazrek tarafından imzalanan 02.Nr.61/26 protokol numaralı ve 18.05.2026 tarihli sözleşmenin ardından, Belediye Başkanı tarafından aşağıdaki karar alınmıştır:

K A R A R

İŞ İLİŞKİSİNİN GEÇİCİ OLARAK ASKIYA ALINMASI HAKKINDA

Madde 1

Kamu Görevlisi Raif Mazrek, Mamuša'daki ATATURK okulunda Öğretmen pozisyonunda görev yapmakta olup, Mamuša'daki ANADOLU okulunda Müdür pozisyonu için belirli süreli iş sözleşmesinde belirtilen süre boyunca iş ilişkisinden askıya alınır.

Madde 2

“ANADOLU” İlk ve Ortaokulu Müdürü olarak görev süresinin sona ermesinden sonra, yürürlükteki mevzuata uygun olarak ilgili kamu görevlisi önceki görev pozisyonuna geri döner; ancak kamu hizmeti ilişkisinin sona erdirilmesine ilişkin ayrı bir karar alınması durumu bu hükmün dışındadır.

Madde 3

Bu karar, Belediye Başkanı tarafından imzalandığı tarihten itibaren derhal yürürlüğe girer.

Bilgi İçin:

- Sayın Raif Mazrek
- Eğitim Müdürlüğü (BEM)
- Arşiv





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 112-26
Datë : 18.05.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr-28/2008, neni 86 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe neni 71 i Ligjit nr. 08/l-197 Për Zyrtarët publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L294, neni 13 paragrafi 3 Ligjin nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/l-197 Për Zyrtarët publik, pas nënshkrimit të kontratës me nr. Protokolli 02.Nr.61/26 e datës 18.05.2026 nga nëpunësi publik Raif Mazrek, Kryetari i Komunës mer këtë

V E N D I M
PËR PEZULLIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Neni 1

Nëpunësi Publik **Raif Mazrek**, i sistemuar në pozitën Mësimdhënës në SH.M.L ATATURK në Mamushë, pezullohet nga marrëdhënia e punës, për periudhën përkatëse të caktuar në Kontratën e punës për kohë të caktuar në pozitën Drejtor i Sh.F.M.U. ANADOLU në Mamushë.

Neni 2

Pas përfundimit të ushtrimit të funksionit si Drejtor i Sh.F.M.U. ANADOLU në Mamushë, në pajtim me legjislacionin në fuqi, nëpunësi publik rikthehet në pozitën e tij të mëparshme të punës, përveçse në rastet kur merret vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë njoftohet

- z. *Raif Mazrek*
- *DKA*
- *Arkiva*





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 No: 711 -26
Tarih: 18.05 -26
Mamuşa

Kosova Cumhuriyeti Resmî Gazetesi'nde yayımlanan 03/L-040 sayılı Yerel Yönetim Yasası'nın 13. ve 58. maddeleri, 04/L-042 sayılı Kamu İhale Yasası ile bunu değiştiren ve tamamlayan 04/L-237, 05/L-068 ve 05/L-092 sayılı yasalar, 001/2022 sayılı Kamu İhale Yönetmeliği'nin değiştirilmesi ve tamamlanmasına ilişkin 002/2024 sayılı Yönetmeliğin 9. ve 72A maddeleri, 05/L-031 sayılı Genel İdari Usul Yasası'nın 26, 44, 45, 46, 47 ve 49. maddeleri ile 01.12.2008 tarihli Mamuşa Belediyesi Statüsü'nün 82. maddesine dayanılarak, Mamuşa Belediye Başkanı aşağıdaki kararı alır:

K A R A R

“Teknik Kabul Komisyonunun Oluşturulması Hakkında”

1. “LESKA–NISRA–LIKA–ASKER TARIMSAL ARAZİ YOLLARINA AİT YARDIMCI ALTYAPININ DÜZENLENMESİ” başlıklı ihale sözleşmesine ilişkin teknik kabul işlemlerini gerçekleştirmek üzere, 626-24-2221-2-2-1 ihale numarası ve 626-24-003-2-2-1 iç numarası kapsamında aşağıdaki üyelerden oluşan komisyon görevlendirilmiştir:

- 1.1. Labinot Muhaxheri – Komisyon Başkanı
- 1.2. Esra Osi – Üye
- 1.3. Bilnur Bitiçi – Üye

2. Teknik Kabul Komisyonu, sözleşme kapsamında gerçekleştirilen işlerin sözleşme şartları ve teknik şartnamelere uygun olarak yerine getirilip getirilmediğini tespit etmekle yükümlüdür. Yapılan inceleme sonucunda düzenlenecek tutanak ile işlerin projeye ve sözleşmeye uygunluğu belgelendirilecektir.
3. Teknik Kabul Komisyonu, işbu kararın imzalanmasının ardından derhal çalışmalarına başlayacak ve talep eden birimin bildirdiği tamamlanmış işlerin teknik kabulünü gerçekleştirecektir.
4. Komisyon, yapılan teknik kabul işlemleri hakkında Sözleşme Yöneticisine ve Satın Alma Ofisine sunulmak üzere bir rapor hazırlamakla yükümlüdür.
5. Bu kararın uygulanmasından komisyon üyeleri ile sözleşme yöneticisi sorumludur.
6. İşbu karar, imzalandığı tarihte yürürlüğe girer.

Bu kararın bir örneği aşağıdaki birimlere gönderilir:

1. İlgili Müdürlük
